



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1099/5 prot

Datë 23.06.2022

V E N D I M

K.P.P. 589/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.06.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Radika” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-27058-04-28-2022, me objekt “Mirëmbajtje Kanale Ujitëse dhe Vaditëse” me fond limit 2,262,500 (dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Radika” SHPK
Adresa: Peshkopi, Dibër, L Gjok Doci.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Bulqizë
Adesa: Lagjia “Minatori”, Bulqizë.

Subjekti i Interesuar: “Shehu” SHPK

Maqellarë, Dibër, Ndërtesa 1-katëshe, me zonë kadastrale nr .2592 dhe me nr. pasurie 440, në Rrugën Nacionale Peshkopi-Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë të Komisionit, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.04.2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Proçedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-27058-04-28-2022, me objekt “Mirëmbajtje Kanale Ujitëse dhe Vaditëse” me fond limit 2,262,500 (dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, parashikuar zhvilluar në datën 10.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

II.2. Në datën 10.05.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 16.05.2022, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

“RADIKA” SHPK	2,048,030.00 lekë	skualifikuar
“SHEHU” SHPK	2,254,595.00 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 16.05.2022 operatori ekonomik “Radika” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon:

Mungojnë:

- 1. Vërtetimi për shlyrjen e taksave vendore për vitin 2021 sipas vendushtrimit të aktivitetit të pasqyruar në QKB.*
- 2. Listpagesa e Shoqërisë për periudhën dhjetor 2021 e në vazhdim.*
- 3. Dokumentacioni i drejtuesit teknik dhe stafit teknik.*
- 4. Dëshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike.*

II.5. Në datën 18.05.2022 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 67, më datë 23.05.2022.

II.6. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 67, më datë 23.05.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku rezulton fitues operatori ekonomik “SHEHU” SHPK.

II.7. Në datën 23.05.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1099/2022 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2215 e operatorit ekonomik “Radika” SHPK njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1099/2022/2 prot., datë 24.05.2022 lidhur me lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Me shkresën nr. 3917 prot., datë 30.05.2022 protokolluar me tonën me nr. 1099/3 prot., datë 01.06.2022, autoriteti kontraktor i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, me kërkesë për shtyerje afati të shqyrtimit të ankesës.

II.10. Me shkresën nr. 4005 prot., datë 02.06.2022 protokolluar me tonën me nr. 1099/4 prot., datë 06.06.2022, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Radika” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor, nuk e ka pranuar ankesën.

II.11. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik si dhe në sistemin e elektronik online, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Radika” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : “[...]Mungojnë:

1. Vërtetimi për shlyrjen e taksave vendore për vitin 2021 sipas vendushtrimit të aktivitetit të pasqyruar në QKB”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, të dokumenteve të tenderit, të ngarkuar në SPE, pikat 2.3, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

2.3.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2021 sipas vendushtrimit të aktivitetit të pasqyruar në QKB. (ky kriter plotësohet me anë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit).

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Radika” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit.

III.1.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.4. Në nenin 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

Në nenin 39, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.5. Referuar ligjit të prokurimit publik, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, rezulton, se për një pjesë të kriterëve të pranimit të kërkuara në dokumentet e tenderit, operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku ofertuesi shprehet se oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit, pjesë e të cilit është edhe kriteri 2.3. *Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2021 sipas vendushtrimit të aktivitetit tëpasqyruar në QKB. (ky kriter plotësohet me anë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit).* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8). Vendosija e kriterëve të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë,

të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret rezulton, se kriteri 2.3 i kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit në dokumentat e tenderit, është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Radika” SHPK me anë të Formularit të Vetëdeklarimit, konkretisht në seksionin A. *Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithme të kualifikimit, sipas së cilit operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP.* Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se operatori ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës dhe në përgatitjen e saj duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Për më tepër, vetë autoriteti kontraktor në hartimin e këtij kriteri kualifikues ka kërkuar që të plotësohet me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Pra, kriteri 2.3 i sipërcituar përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST, siç ka ndodhur në rastin konkret.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Radika” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Radika” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : “[...]Mungojnë:

2.Listpagesa e Shoqërisë për periudhën dhjetor 2021 e në vazhdim.

3.Dokumentacioni i drejtuesit teknik dhe stafit teknik.

4.Deshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7, të dokumenteve të tenderit, të ngarkuar në SPE, pikat 3.4 dhe 3.6, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

3.4 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune me kohë të plotë të përfshirë në listpagesa .

- *Inxhinier Topograf (1) një*
- *Inxhinier ndertimi I (nje)*

*Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **dhjetor 2021 e në vazhdim për secilin pjestar të stafit të paraqitet***

- **-Diploma**
- **-Librezë pune.**

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik si më poshtë:

- **Teknik ndertimi I (një)** për këtë duhet të paraqesë Diplomë të shkollës së mesme, kontratë pune të vlefshme, IQT (ejkujvalente) dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji dhjetor 2021 e në vazhdim.
- **Shofer kamioni I(nje)** Shofer kamioni të punësuar, për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, IQT (ejkujvalente), leje drejtimi mjeti të lëshuar nga organet kompetente dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji dhjetor 2021 e në vazhdim.
- **Manovrator I(një)** të punësuar, për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, IQT (ejkujvalente), leje drejtimi mjeti të lëshuar nga organet kompetente dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji dhjetor 2021 e në vazhdim.
- **Murator I (një)** për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, IQT (ejkujvalente), dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji dhjetor 2021 e në vazhdim.

3.6. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONËSIA	SASIA Minimumi
•	<i>Kamion me kapacitet deri 10 ton</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1 copë</i>
•	<i>Kamioncine deri 3.5 ton</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1 copë</i>

•	<i>Minieskavator</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1 copë</i>
•	<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1 copë</i>
•	<i>Eskavator me goma</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1 copë</i>
•	<i>Vibrator Betoni</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1 copë</i>
•	<i>Autovinç për transport tubash e materialesh</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1 copë</i>
•	<i>Betoniere 0.5 m3</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1 copë</i>

- a) *Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr.9.*
- b) *Pëer mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, si dhe lejen e transportit nga institucionet përkatës.*
- c) *Për automjetet që nuk shënohen në rregjistra publik, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike.*
- e) *Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, (Deklaratë nga Administratori i Shoqërisë Ofertuese).*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Radika” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit për “Radika” SHPK;

- Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit për “Florida” SHPK;

-Kontratë bashkëpunimi mbështetëse më datë 10.05.2022 midis shoqërive “Radika” SHPK dhe “Florida” SHPK.

-Deklaratë angazhimi me datë 10.05.2022 nga administratori i shoqërisë “Florida” SHPK, e cila vë në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore (12 dymbëdhjetë punëtorë), gjatë zbatimit të punimeve.

III.2.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në

ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**”

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Në nenin 39, pika 4 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. KPP sqaron se, kriteri i kualifikimit mbi disponimin e punonjësve dhe mjeteve/makinerive duhet të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik sipas shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit në respektim të nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të VKM, duke përmbushur kriterin kualifikues mbi disponimin e punonjësve dhe mjeteve/makinerive për këtë fazë, ku autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, në plotësimin e këtyre kriteve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE):

-Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit për “Radika” SHPK;

- Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit për “Florida” SHPK;

-Kontratë bashkëpunimi mbështetëse më datë 10.05.2022 midis shoqërive “Radika” SHPK dhe “Florida” SHPK.

-Deklaratë angazhimi me datë 10.05.2022 nga administratori i shoqërisë “Florida” SHPK, e cila vë në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore (12 dymbëdhjetë punëtorë), gjatë zbatimit të

punimeve, dhe në këtë moment operatori ekonomik ankimues duke përmbushur kriterin kualifikues mbi disponimin e punonjësve dhe mjeteve/makinerve për këtë fazë.

Për më tepër, në interpretim të dispozitave ligjore të sipërcituara KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka detyrimin t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. KPP sqaron se, momenti procedural i kërimit të dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik i kualifikuar sipas parashikimeve të reja ligjore, është përpara publikimit të njoftim-fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, në respektim të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285 datë 9.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Radika" SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Radika” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-27058-04-28-2022, me objekt “Mirëmbajtje Kanale Ujitëse dhe Vaditëse” me fond limit 2,262,500 (dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, parashikuar zhvilluar në datën 10.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Radika” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Radika” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri

